



Garë ndërkombëtare KENGUR 15.03.2018**Klasa e parë**

Koha në disponim është 1h e 15 min.

Për përgjigje jo të saktë të pyetjes minusohet një e katërta e numrit të pikëve me të cilat vlerësohet kjo pyetje. Për të shmangur rezultat të përgjithshëm negativ në fund shtohen 10 pikë, kështu që sasia maksimale e pikëve të fituara është 50. Gjatë punës nuk lejohen kalkulatorët


Çdo detyrë vlerësohet me 4 pikë

1. Mira vizaton vijë të thyer në mënyrë të tillë që me segmente i lidh nuselalet që janë të treguara në vizatimin djathtas. Ajo fillon me nuselalen që ka vetëm një pikë dhe çdo nuselale që lidhet më pas ka më shumë pika. Cilën vijë të thyer do të fitojë Mira?




2. Në vizatimin djathtas është paraqitur një picë e cila ka qënë e ndarë në pjesë të barabarta. Sa pjesë të picës mungojnë?

(A) 1 (B) 2 (C) 3 (D) 4 (E) 5





3. Në vizatimin djathtas janë treguar dy parqe me kengurët që janë në secilin park. Sa kengurë duhet të kalojnë nga njëri park në tjetrin me qëllim që të dy parqet të kenë numër të njëjtë kengurësh?

(A) 4 (B) 5 (C) 6
(D) 8 (E) 9



4. Mira sipas një rregulli ndërton kulla. Pesë kullat e para që i ndërtoi janë treguar në vizatimin djathtas. Ç'pamje do ketë kulla me numër 8?



5. Mira me radhitje të pllakave të rrumbullakta formoi kullën e treguar në vizatimin djathtas. Sa pllaka do të shikojë Mira në qoftë se kullën e shikon nga lart?

(A) 1 (B) 2 (C) 3 (D) 4 (E) 5

